



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



13 Nr. Zyrtar – 2023

Më 10.03.2023

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, e në mbështetje të nenit 16 paragrafi 3 dhe 4 të Rregullores – MF – Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Thirrjes Publike me Nr. Prot. 366 të datës 03.02.2023, dhe në mbështetje të vendimit të Kryetarit të Komunës me Nr. Prot.218 të datës 24.02.2023 për caktimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlersimin e aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve në kulturë dhe rini nga DKRS-ja për vitin 2023, Komisioni vlerësues nxjerr këtë:

N J O F T I M

1. Për ndarjen e shumës financiare sipas projekteve për OJQ-të që kanë përbushur kushtet dhe kriteret sipas thirrjes publike për aplikim.
2. Pjesë; përbërëse e këtij njoftimi është lista e përfituesve të subvencioneve në sektorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2023.
3. Pas kalimit të afatit të ankesave dhe të procedurave të tjera të parapara në rregulloret e lartcekura, Kryetari i Komunës do të nënshkruajë kontratat me përfituesit e mjeteve financiare me të gjitha OJQ-të përfituese.

LISTA E PËRFITUESËVE TË SUBVENCIONEVE NË SEKTORIN E KULTURËS 2023

Nr.	EMRI I OJQ / KLUBIT SPORTIV	EMRI I PROJEKTIT
1.	OJQ “Art Studio”	Simpoziumi ndërkombëtar i artit - edicioni i 22-të
2.	Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së	Organizimi i manifestimeve përkujtimore për Dëshmorët e Kombit
3.	Sh.K.A “Bajram Curri”	Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i vlerave kulturore
4.	Qendra Kulturore Artistike “Jehona e Anadrinit”	Roli i festivalit folklorik “Anadrinia Jehon” në ruajtjen dhe kultivimin e traditave kombëtare.
5.	Sh.K.A “Ganimete Tërbeshi”	Plotësimi i gardarobës dhe vizitë të vendeve të shenjta
6.	Sh.K.A “Rahoveci”	N’konak të Rahovecit na bashkon kënga shqipe”
7.	Organizata Kulturore e të Rinjës	Trashëgimia kulturore e Rahovecit për mes fotografisë
8.	Vizioni i Rinisë për Integritet Social	Aktivitetet e Ditëve të Mërgatës 2023

LISTA E PËRFITUESËVE TË SUBVENCIONEVE NË SEKTORIN E RINISË DHE SPORTIT 2023

Nr.	EMRI I OJQ / KLUBIT SPORTIV	EMRI I PROJEKTIT
1.	Klubi i Futbollit Rahoveci	Fuqizimi i sportit të futbollit
2.	Klubi i Karatesë Rahoveci	Karateistët e rinj të Rahovecit
3.	Klubi i Futbollit “Xërxa”	Zhvillimi i aktiviteteve sportive - Futbolli
4.	Klubi i Futbollit “Aanadrini”	Kualifikimi 2023
5.	Shkolla e Futbollit “Drenoci”	Shpallja kampioni i ligës regjionale
6.	Klubi i Basakëtbollit „Rahoveci”	Zhvillimi i aktiviteteve të rinjve të KB Rahoveci
7.	Shkolla e Basketbollit „Halit Hoxha”	Garimi në kampionatin e basketbollit
8	Klubi i Hendbollit „Rahoveci”	Pjesëmarrja në garat vendore e ndërkombëtare dhe puna me grupmoshat
9	Klubi i Futsallit „Rahoveci 2019”	Garimi në kuadër të Superligës së Kosovës
10	Klubi i Shahut „Rahoveci”	Kampionati ekipor i Kosovës në shah 2023
11	Shkolla e Shahut „Gani Daka”	Kampionati ekipor i Kosovës në shah-femra
12	Klubi i Veteranëve të Futbollit „Rahoveci”	Pjesëmarrja në garat zyrtare të Ligës së veteranëve në futboll
13	Shoqata e Çiklizmit „Kokrrat”	Sporti i çiklizimit dhe promovimi i çiklizmit në natyrë në komunën e Rahovecit
14	Klubi i boksit BB-Kastrati	Kampionati i Boksit të Kosovës
15	SHL – Kosova	Të rinjtë kreativ

A r s y e t i m

Komisionet komunale për shqyrtimin e aplikacioneve të organizatave të shoqërisë civile për projektet kulturore, rinore dhe sportive, kanë shqyrtuar projekt-propozimet e OJQ-ve në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit për vitin 2023.

Bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen për aplikim Nr.366 të datës 03.02.2023, komisioni për shqyrtimin e projekt-propozimeve për kulturë, ka pranuar gjithsej 9 (nëntë) aplikacione 8 (tetë) prej të cilave kanë qenë të kompletuara, ndërsa 1 (një) aplikacion është refuzuar për shkak se nuk i ka plotësuar kriteret e paraparë me thirrjen publike për aplikim. Ndërsa komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për projektet e sportit dhe rinisë kanë pranuar 18 (tetëmbëdhjetë) aplikacione, prej të cilave 4 (katër) janë refuzuar për shkak se nuk i kanë plotësuar kriteret sipas thirrjes publike, ndërsa 14 (katërmëdhjetë) i kanë plotësuar kriteret.

Udhëzim Juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtë ankese në afat prej 5 (pesë) ditësh, nga dita e publikimit të tij pranë Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ankesa dorëzohet në sportelin Nr. 7 në katin e I-rë në objektin e Komunës Rr. Dëshmorët e Pashtrikut.